



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:057799

Datë: 07.08.2019

Numri i dokumentit: 00448945

P.nr.645/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i përgjithshëm, Gjyqtarja Diana Sina, me sekretaren juridike Lamije Kuqi, në çështjen penale kundër të akuzuarës F.M. K.Rahovec, për shkak se ka kryer veprën penale të vjedhjes, nga neni 325 par.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore-Dep.përgjithshem në Gjakovë, PP/II.nr.1315/2018, të datës 17.09.2018, në shqyrtimin fillestar, të mbajtur më datën **07.08.2019**, në prani të Prokurorit të shtetit Bajram Kryeziu, të akuzuarës, të njëjtën ditë mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

E akuzuara **F.M.**, nga i ati J. dhe e ëma R. e gjinisë Gj., data e lindjes..., K.Rahovec, ka të kryer katër klasë të shkollës fillore, e martuar- nënë e 6 fëmijëve, amvise, e gjendjes së dobët ekonomike, shqiptare, shtetase e R.së Kosovës, numër personal...

Ë s h t ë f a j t o r e:

Sepse: Me datën 30.08.2018, rreth orës 08:10/h, pikërisht në qendrën tregtare "V.F.S." në Gjakovë, me qëllim të përvetësimit pasuror të kundërligjshëm, tjetrit t' ia marrin pasurinë e luajtshme, në atë mënyrë që pa u vërejtur nga punëtorët ka vjedhur 3 qafore nga 14.25 euro, si dhe një orbit në vlerë 2.7 euro, 2 pare gjoksore në vlerë prej 5.25 euro, e që vlera totale e mallit të vjedhur është 50.65 euro, dhe duke dalur nga qendra tregtare është ndalur nga punëtorët e sigurimit pasi që është identifikuar përmes kamerave, e që gjësendet e vjedhura i janë kthyer të dëmtuarës.

- me çka ka kryer veprën penale, të vjedhjes, nga neni 325 par.1 të KPRK-ës.

Gjykata në bazë të nenit 4, 17 par.1, 41, 46, 49, 50, 51, 52 par.5, 73, dhe nenit 325 par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPK-së, i shqipton;

DËNIM ME KUSHT

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **3 (tre) muaj**, dhe dënim me gjobë në shumë prej **100.-(Njëqind) Euro**, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse e akuzuara brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (Një) viti**, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

Detyrohet e akuzuara që në emër të shpenzimeve procedurale, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **30,00 €**, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

Përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarës Qendra tregtare “V.F.S.” në Gjakovë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti i përgjithshëm, ka ngritë Aktakuzë PP/II.nr.1315/2018 të datës 17.09.2018, kundër të akuzuarës F.M., K.Rahovec, për shkak të veprës penale të vjedhjes, nga neni 325 par.1 të KPRK-ës, dhe ka propozuar që të akuzuarën të shpallë fajtoresh, të dënohet sipas Ligjit dhe të obligohet në kompensimin e shpenzimeve gjyqësore.

E akuzuara F.M. në shqyrtimin fillestar lidhur me fajësinë deklaroi se e pranoi fajësinë ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës, për të cilën veprën jam penduar pa masë dhe premtoi para gjykatës se të njëjtën nuk do ta përsërisë, është e vërtetë që ditën kritike kam gjësendet e cekura në dispozitivin e aktakuzës, këtë veprë e kam bërë pasi jam me kushte shumë të vështira ekonomike, nuk kam asnjë të ardhura, por kjo veprë nuk arsyetohet, kam gabuar pa masë, shton se jam amvisë, nënë e gjashtë fëmijëve, si dhe për herë të parë paraqitem në gjykatë për një veprë të kryer penale, por premtoi se do të jetë edhe hera e fundit, andaj i propozoi gjykatës që ti ketë parasysh këto rrethana me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit.

Duke u deklaruar lidhur me mendimin lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarës, prokurori i shtetit ka deklaruar se nuk e kundërshton pasi që e akuzuara ka pranuar fajësinë me vullnet dhe vetëdije të plotë dhe e njëjta ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe se pranimi i fajësisë u bë në mënyrë të vullnetshme dhe se pranimi mbështetet në faktet dhe provat që përmban aktakuza.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetuar se e akuzuara F.M.: Me datën 30.08.2018, rreth orës 08:10/h, pikërisht në qendrën tregtare “V.F.S.” në Gjakovë, me qëllim të përvetësimit pasuror të kundërligjshëm, tjetrit t’ia marrin pasurinë e luajtshme, në atë mënyrë që pa u vërejtur nga punëtorët ka vjedhur 3 qafore nga 14.25 euro, si dhe një orbit në vlerë 2.7 euro, 2 pare gjoksore në vlerë prej 5.25 euro, e që vlera totale e mallit të vjedhur është 50.65 euro, dhe duke dalur nga qendra tregtare është ndalur nga punëtorët e sigurimit pasi që është identifikuar përmes kamerave, e që gjësendet e vjedhura i janë kthyer të dëmtuarës.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga e akuzuara, e cila në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga e akuzuara është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtarja e vetme gjykues konstatoi se e akuzuara ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga e akuzuara, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarës formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarën të shpall fajtores dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të saj.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarës gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarës: është e pa punë, është nënë e gjashtë fëmijëve, gjendjen e dobët ekonomike, pranimin e fajësisë, pendimin e saj dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, sjelljet tejet korrekte në gjykatë, e sidomos faktin se për herë të parë ndeshet me ligjin, ndërsa si rrethana rënduese Gjykata mur parasysht peshën e veprës penale, rrethanat në të cilat është kryer vepra, të gjitha këto rrethana ndikuan që Gjykata të njëjtës të i shqiptojë dënim me burgim në kohëzgjatje prej **3 (tre) muaj**, dhe dënim me gjobë në shumë prej **100.-(Njëqind) Euro**, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse e akuzuara brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (Një) viti**, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon e akuzuara.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 par.2 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale në emër të paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 453 par.1. të KPP-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i përgjithshëm -
P.nr.645/18 me datën 07.08.2019.

Procesmbajtësja,
Lamije Kuqi

Gjyqtarja e vetme gjyqësore,
Diana Sina

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimin të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.